



**DREJTORIA E SHERBIMEVE
NJESIA E PROJEKTIT DHE INFRASTRUKTURES**

RELACION TEKNIKE


Reabilitim rruga "Egnatia" Loti II



Durres 2019

Relacion teknik

OBJEKTI: REHABILITIMI RRUGA "EGNATIA", LOTI II



Objekti eshte i pozicionuar ne Rrugen Egnatia, pjesa e rruges eshte e ndare nga 2 segmente. Segmenti i pare fillon nga qendra tregtare "Flagship" deri tek rrrethrrrotullimi tek stacioni I treni. Segmenti i dyte fillon nga shkolla "Jusuf Puka" deri ne kryqezimin e rruges "Grigor Durrsaku". Rikonstruksioni i kesaj pjese rruge eshte vazhdim me dy projektet e zbatuara ne rrugen "Egnatia" dhe kuarteret. Per nga vete pozicioni strategjik si rruge kryesore e cila te con drejt qendres se qytetit dhe portit, si edhe rendesise per shkak te bizneseve qe ndodhen ne

te, do te ndikoje ne zhvillimin e qytetit, duke i dhene keshtu nje tjeter dimension. Projekti konsiston ne rikualifikimin e saj duke ruajtur gjuhen arkitektonike te objekteve te zbatura me pare ne qytet. Ky projekt integrohet me se miri me kontekstin e zones.

Rruga ekzistuese ne segmentin e pare nga rotonda stacioni i trenit deri tek "Flagshipi" ka gjeresi 12m me trotuare mesatarisht 4.5m. Rruga ekzistuese ne segmentin e dyte nga shkolla "Jusuf Puka" deri tek kryqezimi i rruges "Grigor Durrsaku" ka gjeresi 15m dhe trotuaret 4.5m. Kjo rruge i ka kanalizimet e ujrave te bardha, por per shkak te problematikes se kesaj zone ne rastet e permbytjeve gjate shirave, parashikohet vendosja e dy kolektoreve te rinje ne te dyja anet e trotuareve per mbledhjen e tyre, me puseta me kapak metalik te zinkuar cdo 50m dhe ndermjet tyre 25m larg pusete me kapak ne gur trani me kanale. Gjithashtu parashikohet ngritia e pusetave ne rruge dhe trotuare. Ndersa per kanalizimet e ujrave te zeza parashikohet qe dy kolektoret te cilat ndodhen ne anen e portit te lidhen me dy puseta per te dale jashte gjurmese se rruges me nje pusete, e cila do te lidhet me pas me projektin qe do te zhvillohet nga Banka Boterore per largimin e ujrave te zeza ne kolektorin e rruges paralel me portin. Ndrizimi dhe linjat elektrike jane te amortizuara e kane konsum te larte te energjise elektrike.

Mungojne linja rezerve per vendosjen e infrastruktures ne te ardhmen (elektrike, linja interneti, kullim ujrat e shiut, etj).

Zgjidhja e gjelberimit do te permiresohet me realizimin e projektit.

Foto nga gjendja ekzituese






Planimetria e pergjithshme

Aksi nga qendra "Flagship" deri tek rotonda stacioni trenit

Projekti shtrihet nga qendra tregtare Flagship deri ne rotonden prane Stacioni te trenit. Duke pasur parasysh ndryshimet ne qender te qytetit dhe vlerat qe mbart kjo zone, urbane dhe ekonomike, projekti ka nderhyre ne te gjitha elementet kompozicionale te rrugeve, mobilimit urban si dhe infrastruktureve.




Projekti i propozuar ruan te njejtin aks me pjesen e ndertuar te rruges Egnatia. Permaza e rruges ku qarkullojne automjetet nga qendra tregtare Flagship deri ne rotonden e stacionit te trenit eshte 10.32m, duke ruajtur nga te dyja drejtimet korsite e parkimit me nga 2 m secila. Trotuaret variojne nga 4.5m gjeresi deri ne 14.5 m, duke bere te mundur vendosjen e stolave per qytetaret, dy vaska uji, shtylla ndricimi dhe peme te reja. Trotuaret ne fillim dhe ne fund te tyre zgjerohen, duke krijuar vendkalime per kembesoret dhe xhepa per parkimet e makinave, te cilat jane realizuar me gur albanera dhe ne perimeter te tyre me travertine. Rruga do te jete ne nje kuote me trotuaret, dhe lidhja me rrugicat do te behet me rampa betoni te stampuara, te cilat ne perimeter te tyre do te kene gur tip i bardhe. Kuotat e projektit ne rruge jane 10cm mbi kuotat ekzistuese.

Gjatesia e pergjithshme e projektit ne aksin e tij eshte **200** m lineare.

Terreni ka nje pjerresi natyrale e cila vjen nga rrrethrrrotullimi e ulet ne drejtimin qendres tregtar "Flagship". Edhe ne projekt pjerresia ekzistuese e rruges do te ruhet.

Aksi nga rruga “Egnatia” nga shkolla “Jusuf Puka” deri tek rrethrrotullimi i ruges portit



Projekti i propozuar ruan te njejtin aks me pjesen e ndertuar te rruges Egnatia. Permaza e rruges ku qarkullojne automjetet nga shkolla "Jusuf Puka" deri ne kryqezimin e rruges "Grigor Durrsaku" eshte 10.32m, duke ruajtur nga te dyja drejtimet korsite e parkimit me nga 2 m secila. Trotuaret variojne nga 4.5m gjeresi deri ne 14.5 m, duke bere te mundur vendosjen e stolave per qytetaret, dy vaska uji, shtylla ndricimi dhe peme te reja. Trotuaret ne fillim dhe ne fund te tyre zgjerohen, duke krijuar vendkalime per kembesoret dhe xhepa per parkimet e makinave, te cilat jane realizuar me gur albanera dhe ne perimeter te tyre me travertine. Rruga do te jete ne nje kuote me trotuaret, dhe lidhja me rrugicat do te behet me rampa betoni te stampuara, te cilat ne perimeter te tyre do te kene gur tip i bardhe. Kuotat e projektit ne rruge jane 10cm mbi kuotat ekzistuese.

Gjatesia e pergjithshme e projektit ne aksin e tij eshte **190** m lineare.

Materialet kryesore te perdorura do te jene:

1. Gur trani ne te gjitha trotuaret, te vendosura ne drejtimin sikurse paraqitur ne projekt. Plakat do te kene trashesi 6cm, me gjeresi nga 20cm deri ne 40 cm dhe gjatesi variabel.
2. Travertine ne perimeter te trotuareve, posteve te parkimit dhe shirita me travertine ne trotuare cdo 1m.
3. Gur albanera i vendosur ne parkimet e makinave dhe rrerhrotullim.
4. Rampa betoni te stampuara ne rruge.
5. Gur tip i bardhe vendi ne perimeter te rampave te betonit dhe ne zonen e rrerhrotullimit.
6. Kunete ne gur trani gjate gjithe gjatesise dhe ne te dyja anet e trotuareve dhe ne pusetat e kontrollit te kanalizimeve te ujравe te bardha do te vendosen kapake metalike te zinkuar cdo 50m dhe ndermjet tyre 25m larg kapak ne gur trani me kanale per kullimin e ujравe te shiut.
7. Mozaik me pllaka qeramike me shkelqim ne stola dhe vaskat e ujit, ne ngjyre blu dhe te verdhe.
8. Shtrese asfalti ne rruge.

Sa i takon shtresave te tjera, ato jane te detajuara ne projekt dhe preventiv.


Pergjate rruges jane pozicionuar poste parkimi per automjete dhe post parkimi per bicikletat prane. Gjithashtu do te jene edhe vende ndalimi per autobuset ne te dyja drejtimet dhe vende parkimi per taxi-t.

Rruga eshte shoqeruar me kunete ne gur trani nga te dyja anet, me seksion tip 30cm dhe trashesi 8cm. Gjate gjatesise se tyre jane vendosur sipas planimetris se projektit dhe pusetave te reja te kontrollit cdo 25m me dimensione 70x30cm te kanalizimeve te ujrale te bardha, kapake metalike te zinkuar cdo 50 m dhe ndermjet tyre 25 m larg kapak ne gur trani me kanale per kullimin e ujrale te shiut. Per shkak te permbytjeve gjate periudhes se shirave ne kete objekt do te behen dy kolektore te rindje te ujrale te bardha, ne te dyja trotuaret. Ndersa per kanalizimet e ujrale te zeza parashikohet qe dy kolektoret te cilat ndodhen ne anen e portit te lidhen me dy puseta per te dale jashtë gjurmës se rruges me një pusete, e cila do te lidhet me pas me projektin qe do te zhvillohet nga Banka Boterore per largimin e ujrale te zeza ne kolektorin e rruges paralel me portin. Gjithashtu eshte parashikuar një ngritje e pusetave KUZ ne rast se do te jete nevoja, si pasoje e mbushjes se terrenit.

Ndrizimi ka një rol te rendesishem ne kete projekt. Gjate gjithe gjatesise se trotuareve do te kete shtyllat te larta, te cilat jane marre te njejtë me sheshin Liria per vazhdimin e një linje kompozicionale.


Gjelberimi eshte parashikuar me peme te reja palma sipas projektit.

Detaj i rampave ne rruge




det. 1.A

Detaj i vendparkimit te bicikletave



det. 5.A



Sez. A-A

Grupi projektimit:

Ark. Adnand Toçila

Ark. Oltjon Grucka

Ing. Bora Hysi

Ing. Elek Mariglen Jahollari



**DREJTORIA E SHERBIMEVE
NJSIA E PROJEKTIT DHE INFRASTRUKTURES**

RELACION TEKNIK


**“Reabilitim rruga e "DESHMOREVE", nga
kryqezimi i sheshit "Pranvera"
deri te kryqezimi me rrugen "Mujo Ulqinaku".**



Relacion teknik

"Reabilitimi rruga e "DESHMOREVE", nga kryqezimi i sheshit "Pranvera" deri te kryqezimi me rrugen "Mujo Ulqinaku".

Objekti eshte i pozicionuar prane qendres se qytetit, ne rrugen “Deshmoret”, rruge e cila shtrihet nga stacioni i Trenit deri te Mauzoleumi i Deshmoreve. Rikualifikimi i ketij segmenti rruge, per nga vete pozicioni strategjik eshte nje segment qe lidh pallatin e sportit Ramazan Njala me Mauzoleumin e Deshmoreve. Projekti konsiston ne rikualifikimin e saj duke ruajtur gjuhen arkitektonike te objekteve te zbatura me pare ne qytet. Ky projekt integrohet me se miri me kontekstin e zones.



Rruga ekzistuese ka gjeresi 15 m nga kryqezimi i rruges “Deshmoret” me rrugen “Mujo Ulqinaku” deri ne kryqezimin e sheshit “Pranvera” , me trotuare mesatarisht 5m. Kjo rruge i ka kanalizimet e ujrage te bardha, por per shkak te problematikes se kesaj zone ne rastet e permbytjeve gjate shirave, parashikohet vendosja e dy kolektoreve te rinj ne te dyja anet e trotuareve per mbledhjen e tyre, me puseta me kapak metalik te zinkuar cdo 50m.Gjithashtu parashikohet ngritja e pusetave ne rruge


dhe trotuare. Mungojne linja rezerve per vendosjen e infrastruktures ne te ardhmen (elektrike, linja interneti, kullim ujrat e shiut, etj).

Zgjidhja e gjelberimit do te permiresohet me realizimin e projektit.

Foto nga gjendja ekzituese



Planimetria e per gjithshme



Projekti i propozuar ruan te njejtin aks me te rruges "Deshmoret". Permaza e rruges ku qarkullojne automjetet nga sheshi "Pranvera" deri ne kryqezimin "Mujo Ulqinaku" eshte 8m, duke ruajtur nga te dyja drejtimet korsite e parkimit me nga 2.5 m dhe 3.2 m secila.

Trotuaret variojne nga 4.5m gjeresi deri ne 17 m, duke bere te mundur vendosjen e stolave per qytetaret, shtylla ndricimi dhe peme te reja.

Trotuaret ne fillim dhe ne fund te tyre zgjerohen, duke krijuar vendkalime per kembesoret dhe xhepa per parkimet e makinave.

Kuotat e trotuarit eshte me lart se kuota e rruges .

Ndersa ne kryqezimin te sheshi Pranvera te rrerhrotullimit kuota e rruges do te jetë njesoje me ate ekzistuese. Kryqezimi do te rregullohet me nje rrerhrotullim me diameter 16.70m dhe dy korsite e qarkullimit 3.5 m secila.

Materialet kryesore te perdonura do te jene:

1. Gur trani ne te gjitha trotuaret, te vendosura ne drejtimin sikurse eshte paraqitur ne projekt. Pllakat do te kene trashesi 6cm, me gjeresi nga 20cm deri ne 40 cm dhe gjatesi variabel.
 2. Travertine ne perimeter te trotuareve dhe shirita me travertine ne trotuare cdo 1m.
 3. Gur albanera dhe pllaka betoni gjysme te depertueshme $60 \times 60 \times 10$ cm te kombinuara me tapet bari, te vendosur ne rrrethrotullim.
 4. Rampa betoni me cimento te bardhe per kalimin e kembesoreve $t=22$ cm.
 5. Bordure me gure vendi i bardhe ne perimeter te trotuareve dhe rrrethrotullimeve.
 6. Kunete betoni 40×15 cm e vendosur ne te dy anet e rruges dhe pusetat e kanalizimeve te ujrave te bardha do te vendosen me kapake metalike te zinkuar cdo 25m.

7. Shtresat rrugore:

Shtrese asfalti 5 cm
Shtrese binderi 6 cm
Shtrese stabilizanti 10cm
Çakull 2x20 cm
Dhe natyral

 8. Shtresat e trotuarit: Gur trani 6 cm
Llaç cimento 1:2,5-6 cm
Beton i armuar 8 cm
Stabilizant 10 cm
Çakull 20 cm
Dhe natyral

Planimetria e zones serréthrrrotullimit



Pergjate rruges jane pozicionuar 27 poste parkimi per automjete dhe një stacion qendrimi per autobuzat urban e linjes se Plazhit, Golem, Shkozët. Gjithashtu do te jene edhe vende parkimi per taxi-t.

Gjatesia e pergjithshme e projektit ne aksin e tij eshte **300** m lineare.

Terreni ka nje pjerresi natyrale e cila vjen nga rrrethrrrotullimi e ulet ne drejtimin qendres tregtar Blue Star dhe nga rrrethrrrotullimi ulet per nga sheshi 26 Nentori. Edhe ne projekt pjerresia ekzistuese e rruges do te ruhet.


Rruga eshte shoqeruar me kunete betoni nga te dyja anet, me seksion 40cm dhe trashesi 15cm. Gjate gjatesise se tyre jane vendosur sipas planimetrisë se projektit dhe pusetave te reja te kontrollit cdo 25m me dimensione 70x30cm te kanalizimeve te ujравe te bardha me kapake metalike te zinkuar. Per shkak te permbytjeve gjate periudhes se shirave ne kete objekt do te behen dy kolektore te rinj te ujравe te bardha, ne te dyja trotuaret. Ndersa per kanalizimet e ujравe te zeza parashikohet qe dy kolektoret te cilat ndodhen ne anen e portit te lidhen me dy puseta per te dale jashtë gjurmës se rruges me nje pusete, e cila do te lidhet me pas me projektin qe do te zhvillohet nga Banka Boterore per largimin e ujравe te zeza ne kolektorin e rruges paralel me portin. Gjithashtu eshte parashikuar nje ngritje e pusetave KUZ ne rast se do te jete nevoja, si pasoje e mbushjes se terrenit.

Ndrizimi ka nje rol te rendesishem ne kete projekt. Gjate gjithe gjatesise se trotuareve do te kete shtyllat te larta, te cilat jane marre te njejte me sheshin Liria per vazhdimin e nje linje kompozicionale.


Gjelberimi eshte parashikuar me peme te reja palma washington robusta sipas projektit.

Detaj i rampave ne rruge


Detaj i vendparkimit te bicikletave




det. 1.A



simazhe te stolave me rezine



det. 5.A







Grupi projektimit:

Ark. Adnand Toçila
Ark. Oltjon Grucka
Ing. Bora Hysi
Ing. Elek Mariglen Jahollari